



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


Nr. 02/44

Datë: 27.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushëveprimtarisë së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

**KONCEPT DOKUMENTI PËR RREGULLIMIN E**  
**FUSHËVEPRIMITARISË SË DHOMËS SË POSAÇME TË**  
**GJYKATËS SUPREME**

## **Kapitulli 1: Hyrje**

Hartimi i Koncept Dokumentit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (më tej referuar si "DhPGjS") bazohet ne Planin Vjetor të Punës se Qeverisë për vitin 2018. Më konkretisht, ky koncept dokument bën pjesë tek Prioriteti Strategjik i Qeverisë Nr. 1. Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit, nën objektiven 1.3 - Fuqizimi i kornizës ligjore në fushën e të drejtës civile.

Për shkak të fushëveprimit dhe kompetencave të kësaj Gjykate, ky koncept-dokument është gjithashtu i ndërlidhur me Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore, i cili jep rekomandime në lidhje me masat e politikave kyçe, përfshirë edhe DhPGjS. Më konkretisht, ndër të tjera Strategjia në fjalë parasheh rekomandime për zvogëlimin e numrit të rasteve të pazgjidhura në këtë gjykatë. Ngjashëm, Strategjia rekomandon miratimin e akteve nënligjore që përcaktojnë kushtet (relativisht strikte) që duhen përmbushur për pretendimet pronësore për t'u shqyrtuar nga kjo Gjykatë.

Për fund, si pasojë e prezencës së gjyqtarëve ndërkombëtarë/EULEX në përbërje të trupave gjykues në këtë gjykatë, koncept-dokumenti për DhPGjS gjithashtu është i ndërlidhur ngushtë me çfarëdo zhvillime eventuale që mund të ndodhin nga muaji qershor 2018 në lidhje me mandatin e EULEX-it në fushën e gjyqësorit.

## **Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor**

DhPGjS është trashëgimtare ligjore e DhPGjS-së për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, e themeluar fillimisht përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 (më tej e referuar si "Rregullorja nr. 2002/13"), e cila është ndryshuar më pas nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/4.

Që nga 1 janar 2012 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 04/L-033 për DhPGjS (më tej referuar si "Ligji për DhPGjS"), i cili përveç se ka shfuqizuar Rregulloren nr. 2002/13, riemëroi gjykatën si DhPGjS për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ligji për DhPGjS përcakton juridiksionin dhe kompetencat e DhPGjS si dhe rregullat për organizimin dhe funksionimin e saj, si dhe emërimin e gjyqtarëve që shërbejnë brenda saj. Ndonëse sipas nenit 1.3 të Ligjit për DhPGjS, kjo gjykatë është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 21 të Ligjit nr. 03/L-199 mbi Gjykatat, e njëjta rregullohet me këtë ligj të veçantë.

Me nenin 6 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, nr.04/L-273, është ndryshuar neni 3 i Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe në bazë të këtyre

ndryshimeve ligjore është paraparë që DhPGjS t'i ketë gjithsej 13 gjyqtarë vendor dhe 7 ndërkombëtarë/EULEX-it, dhe atë: 10 gjyqtarë vendorë në shkallën e parë, 3 gjyqtarë vendorë në shkallën e dytë, 5 gjyqtarë ndërkombëtarë/EULEX-it në shkallën e parë, si dhe 2 gjyqtarë ndërkombëtarë/EULEX-it në shkallën e dytë.

Ligji për DhPGjS, i cili përfshin edhe Shtojcën, ndër të tjera përcakton juridiksionin dhe kompetencat e kësaj gjykate. Njëkohësisht përcakton rregullat për përbërjen, organizimin dhe emërimin e gjyqtarëve, organizimin dhe funksionimin e saj, si dhe emërimin e gjyqtarëve që shërbejnë brenda saj. Pjesë po aq e rëndësishme e këtij ligji është edhe Shtojca, e cila përcakton rregullat e punës në lidhje me rastet dhe lëndët brenda kompetencës së saj. Megjithatë, ndonëse e drejta procedurale para kësaj Gjykate është e rregulluar përmes Shtojcës së lartpërmendur, në pjesët ku nuk rregullohet specifikisht me Ligjin për DhPGjS, parashihet që të aplikohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore *mutatis mutandis*. Duhet pasur parasysh se në Ligjin për DhPGjS shprehimisht përcaktohet se dispozitat e këtij ligji mbizotërojnë mbi secilën dispozitë që nuk përputhet me të në cilëndo rregullore, ligj apo akt tjetër nënligjor.

Ndonëse e themeluar që në vitin 2002, aktualisht kjo Gjykatë ballafaqohet me një sërë problemesh, të cilat në thelb ndërlidhen me mënyrën e funksionimit të kësaj gjykate si dhe ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe cilësinë e proceseve gjyqësore. Një sërë çështjesh që kanë rezultuar si faktorë që kontribuojnë në ngecjen e proceseve për zgjidhje të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme të lëndëve janë paraqitur dhe do të shtjellohen më gjerësisht më poshtë:

- korniza ligjore rreth funksionimit të gjykatës në përgjithësi, e veçanërisht përbërja e gjykatës dhe e kolegjeve;
- kriteret për emërimin e gjyqtarëve pranë DhPGjS;
- sistemi i menaxhimit të lëndëve brenda gjykatës;
- grumbullimi i një numri të madh të lëndëve;
- kohëzgjatja e procedurave në lëndë të vjetra;
- koordinimi dhe raportimi në KGjK;
- pengesat procedurale dhe ligjore të tjera.

Një ndër problemet kryesore i cili është përmendur si shqetësim vazhdimisht gjatë vitit të fundit të veprimtarisë së kësaj Gjykate është përbërja dhe forma e funksionimit të brendshëm të gjykatës, sidomos sa i përket kolegjeve. DhPGjS funksionon si gjykatë dy shkallëshe, me pesë Kolegje të Specializuara në shkallë të parë, secila me një panel prej 3 gjyqtarësh dhe një Kolegj të Apelit si shkallë e dytë, e përbërë prej 5 gjyqtarësh, në të cilin Kryetari i DhPGjS-së shërben si kryesuesi i Kolegjit.

Secili prej 5 Kolegjeve të Specializuara është i profilizuar me një kompetencë primare. Kolegji i parë trajton kërkesat që rrjedhin nga procesi i privatizimit ndërsa Kolegji i dytë trajton kërkesat dhe çështjet tjera në lidhje me të drejtat e punëtorëve sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13. Kolegji i tretë trajton kërkesat pronësore dhe kreditore ndërsa Kolegji i katërt trajton kërkesat në lidhje me likuidimin e Ndërmarrjeve Shoqërore (më tej referuar si "N.Sh.") të kryer nga AKM apo AKP. Së fundmi, Kolegji i pestë trajton të gjitha kërkesat dhe çështjet tjera që janë iniciuar sipas apo brenda fushëveprimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48<sup>1</sup> apo ligjeve pasardhëse të saj.

Mirëpo në praktikë strukturimi i tillë në kolegje me kompetenca ekskluzivisht të ndara, pa ndonjë dallim të llojit apo kompleksitetit të lëndës, ka rezultuar në krijimin e ngecjeve në përmbylljen e lëndëve. Kjo sidomos që nga viti 2012 e më tej, kur DhPGjS është ballafaquar me një rritje të ndjeshme të numrit të lëndëve që janë regjistruar në Kolegjin e katërt – lëndët që rrjedhin nga procedurat e likuidimit të N.Sh.-ve.

Ndarja në kolegje dhe vendim-marrja në një kolegji të përbërë prej tre gjyqtarësh, ku njëri prej të cilëve është e paraparë me ligj që të jetë patjetër gjyqtar ndërkombëtar/EULEX, në shumicën e rasteve ka shkaktuar vonesa të theksuara në përmbylljen e një lënde. Një ndër arsyet për këtë është vendimmarrja e përbashkët e të tre anëtarëve të kolegjit, që në praktikë nuk është lehtësisht e arritshme. Më tej, pavarësisht nëse lënda është e natyrës jo-komplekse, siç është p.sh. kërkesa e një punëtori për përfshirjen në listat e 20%-shit, apo edhe vendimet procedurale, siç është p.sh. rasti tek pezullim i procedurës në rast të ndërmarrja ka hyrë në likuidim, duhet patjetër të shqyrtohet nga kolegji në përbërje të plotë dhe të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e kolegjit. Vonesat shtohen edhe më tej si pasojë e faktit që të gjithë shkresat e lëndës në fjalë të përkthehen për nevoja të gjyqtarëve ndërkombëtarë/EULEX.

Neni 9 i Ligjit për DhPGjS aktualisht mundëson që çdo Kolegji i specializuar përmes një Urdhri të delegojë zhvillimin e një pjese të procedurës apo plotësisht vendimmarrjen tek një nën-kolegji prej dy anëtarësh apo edhe te një gjyqtar i vetëm. Aktgjykimi apo aktvendimi i marrë nga nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm ka të njëjtin efekt si ai i lëshuar nga një kolegji i plotë dhe mund të apelohej në Kolegjin të Apelit sipas kushteve të përcaktuara në ligj për Apel. Mirëpo, përkundër praktikitetit edhe efikasitetit që kjo dispozitë mundëson, në praktikë aplikohet shumë rrallë.

<sup>1</sup> Shfuqizuar me Ligjin nr. 04/-L-035 Për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre I ndryshuar dhe plotësuar me Ligji Nr. 05/L -008 (2015).

Kjo dispozitë, në formën siç është formuluar, nuk ka ndonjë kufizim në llojin e lëndëve apo rastet se kur mund të delegohet lënda në një nën-kolegj apo te një gjyqtar i vetëm. Nga ana tjetër, formulimi i saj qartësisht lë të kuptohet se aktvendimet apo aktgjykimet e lëshuara në këtë formë kanë të njëjtën vlerë juridike si ato të lëshuara nga një Kolegj i plotë. Rrjedhimisht, kjo dispozitë është një ndër format më praktike që parasheh ligji aktual për përshpejtimin e proceseve, sidomos duke zvogëluar barrierat për mbajtjen e seanceve dhe shqyrtimeve në kolegj të plotë prej tre anëtarësh.

Ndonëse nuk ekziston ndonjë justifikim konkret se përse kjo dispozitë apo masë lehtësuese për përshpejtimin e lëndëve nuk aplikohet më shpesh nga kjo Gjykatë, duhet pasur parasysh se DhPGjS është pjesë e Gjykatës Supreme. Një ndër arsyet se përse me ligjin për DhPGjS ishte paraparë që kjo gjykatë të vendosë në kolegj prej 3 gjyqtarësh ka të bëjë me faktin se Gjykata Supreme shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegj me nga tre (3) gjyqtarë profesionistë, më përjashtim kur me ligj parashihet një numër më i madh i gjyqtarëve (neni 21.6 i Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat).

Më tej, ndryshe nga të gjithë gjykatat e tjera në sistemin gjyqësor, DhPGjS ka një numër të caktuar të gjyqtarëve që e përbëjnë atë. Më konkretisht, neni 3 i Ligjit për DhPGjS përcakton se kjo gjykatë do të përbëhet nga një numër deri 20 gjyqtarë, pra duke caktuar numrin maksimal të gjyqtarëve të cilët mund të emërohen. Më sipër është detajuar edhe struktura e përbërjes së kolegjeve të specializuara dhe atij të apelit, përfshirë edhe angazhimin e gjyqtarëve të EULEX-it/ndërkombëtarë<sup>2</sup>. Emërimet për këta të fundit vijnë drejtpërdrejtë nga misioni i EULEX-it në përputhje me rregullat e tyre të brendshme. Ndërsa emërimet sa i përket gjyqtarëve vendorë vijnë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (referuar më tej si "KGjK").

Një problem tjetër i identifikuar në funksionimin e kësaj gjykate ka të bëjë me kriteret dhe formën e emërimit të gjyqtarëve. Më konkretisht, emërimi, ri-emërimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve që janë shtetas të Kosovës bëhet në pajtim me të njëjtin proces dhe kërkesa që vlejné për emërimin, ri-emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Sipas Ligjit për Gjykatat<sup>3</sup>, gjyqtari në Gjykatën Supreme duhet të ketë së paku 8 vite përvojë si gjyqtar. Nga ana tjetër, vet ligji për DhPGjS nuk përcakton konkretisht vitet e përvojës së punës së gjyqtarëve, por siç u tha më sipër, aplikon analogjinë si në Gjykatë Supreme për gjyqtarëve vendorë dhe për ata ndërkombëtarë/EULEX i referohet rregulloreve të brendshme të mandatit. Sipas kësaj të fundit, një gjyqtar

<sup>2</sup> Siç është ndryshuar përmes nenit 6 i Ligjit nr. 04/L-273 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

<sup>3</sup> Neni 9 i Ligjit nr. 05/L-032 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat.

ndërkombëtar/EULEX duhet të ketë 5 vite përvojë pune si gjyqtar apo 10 vite përvojë pune profesionale ligjore.

Një ndër problemet kryesore që kjo Gjykatë ballafaqohet sa i përket rekrutimit të gjyqtarëve të rinj është pikërisht kriteri i përvojës së punës, i cili përmbushet me vështirësi nga gjyqtarët vendorë. Në shumicën e rasteve, gjyqtarët promovohen në këtë Gjykatë, mirëpo sipas praktikës së mëparshme, shpesh herë gjyqtarët vendorë që janë emëruar në DhPGjS pa asnjë vit përvojë si gjyqtar. Kjo çështje bëhet edhe më problematike në rastin e përfundimit eventual të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë/EULEX-it, sidomos në lidhje me vështirësitë që do të shfaqen në përmbushjen e pozitave të lira të gjyqtarëve.

Një problem i hasur shpesh në lidhje me kriteret edhe emërimin e gjyqtarëve vendorë në këtë gjykatë ka të bëjë edhe me faktin se shumica e gjyqtarëve që synojnë promovimin kanë për qëllim emërimin pranë Gjykatës Supreme dhe jo DhPGjS. Për më tepër, për shkak të natyrës specifike të lëndëve që trajtohen nga kjo gjykatë, përvoja profesionale dhe ekspertiza specifike është kyçe në rekrutimin e gjyqtarëve. Mirëpo, aktualisht gjyqtarët vendorë nuk i përmbushin apo i përmbushin pjesërisht kushtet e përcaktuara përmes nenit 3 paragrafi 7 i Ligjit për DhPGjS (përvoja substanciale profesionale) të kombinuara me vitet e përvojës së punës si gjyqtar prej 8 vitesh.

Ndonëse DhPGjS është pjesë e Gjykatës Supreme, duke qenë se rregullohet me ligj të veçantë, ndryshe nga Gjykata e tjera në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, edhe mënyra e funksionimit dhe organizimit të brendshëm është paraparë brenda të këtij ligji.

Sipas Ligjit për DhPGjS, (neni 3 para. 5) Kryetari zgjidhet nga vetë gjyqtarët e saj mirëpo ajo që është identifikuar si problematike në lidhje me këtë proces është fakti se procedura e përzgjedhjes nuk është e përcaktuar në ligj. Për më tepër, dispozita në fjalë nuk referon as në ndonjë akt nënligjor, qoftë edhe nga Presidiumi për mënyrën dhe procedurat konkrete të përzgjedhjes së kryetarit të Gjykatës. Nga ana tjetër, vet ligji për KGjK-në, me plotësim-ndryshimet e tij, shprehimisht parasheh kompetencën e këtij organi për nxjerrjen e rregullores për procedurën e përzgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe të kryetarëve të gjykatave, pra duke mos përfshirë këtu DhPGjS-në. Rrjedhimisht, edhe Rregullorja e KGjK-së (09/2016)<sup>4</sup> e cila përcakton procedurat e zgjedhjes, emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave si dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, nuk i referohet fare emërimit të kryetarit të DhPGjS.

---

<sup>4</sup> Rregullorja nr. 17/2016 për ndryshimin e Rregullores nr. 14/2016 për ndryshim dhe plotësimin e Rregullores nr. 09/2016.

Gjykatat e tjera në sistemin gjyqësor të Kosovës parashohin udhëheqjen e punës së një gjykate nga Kolegjiumi, i cili përbëhet nga të gjithë gjyqtarët e asaj Gjykate dhe kryetari. Mirëpo, Rregullorja nr. 03/2014, e cila përmend specifikisht edhe DhPGjS-në në fillimet e saj, në dispozitat në vijim të saj, përshkrimi i organizimit shpesh herë anashkalon apo bie në kundërshtim me Ligjin për DhPGjS. Sa i përket Kolegjiumeve, kjo Rregullore parasheh Kolegjiumin e Gjykatës Supreme, i cili përbëhet nga të gjithë gjyqtarët e kësaj gjykate, që nënkupton se përfshin edhe gjyqtarët e DhPGjS-së, si pjesë e Gjykatës Supreme.

Nga ana tjetër, vet Ligji për DhPGjS parasheh se përveç Kryetarit të Gjykatës, kjo e fundit ka edhe Presidiumin. Presidiumi përbëhet nga Kryetari (sipas Ligjit për DhPGjS kryetari i Gjykatës njëkohësisht shërben edhe si kryetar i kolegjit të Apelit) dhe Kryesuesit e pesë Kolegjeve të Specializuara. Këta të fundit në fakt sipas Ligjit për DhPGjS përzgjidhen nga Kryetari i Gjykatës, i cili njëkohësisht përcakton edhe kompetencën primare të secilit kolegji të specializuar. Nga ana tjetër, Presidiumi emëron anëtarët e tjerë të Kolegjeve të Specializuara. Presidiumi është i ngarkuar me një sërë kompetencash rregullative dhe organizative, të cilat për nga natyra e rregulla që nxjerrin, kanë ndikim thelbësor në mbarëvajtjen e punës së kësaj Gjykate. Një çështje që mund të ngre shqetësime është fakti se anëtarët e Presidiumit, të ngarkuar me kompetencat si më sipër, emërohen nga vet Kryetari i DhPGjS-së, i cili përfundimisht sipas Ligjit zgjedhet nga gjyqtarët e DhPGjS-së. Kjo formë e organizimit dhe emërimit të anëtarëve dhe kryetarit mund të krijojë apo lejojë hapësira për ndikim apo presion si “shpërblim” për emërim qoftë si anëtar i Presidiumit apo anasjelltas, si kryetar i gjykatës.

Presidiumi për nga përbërja ndonëse krahasohet me Kolegjiumin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme siç parashihet me Rregullores së KGjK-së për organizimin e brendshëm të gjykatave, megjithatë me kompetenca shumë më të fuqizuara. Ndryshe nga funksioni i brendshëm i Gjykatave të tjera, ku lëndët cakton me short i tërhequr nga secili gjyqtar, por i mbikëqyrur nga administratori i gjykatës, sipas nenit 3 paragrafit 9 të Ligjit për DhPGjS, Kryetari cakton kompetencat primare të secilit Kolegji, ndërsa Presidiumi me rregulla të posaçme vendos për caktimin e lëndëve specifike pranë Kolegjit përkatës, sipas kompetencës së përcaktuar nga Kryetari.

Presidiumi vendos rregulla procedurale që kanë fuqi ligjore<sup>5</sup>, cakton anëtarët e kolegjeve të specializuar, ndërsa anëtarët e Kolegjit të Apelit i cakton Kryetari i DHP në konsultim

<sup>5</sup> Neni 10.5 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 “Vendimet procedurale të Presidiumit sipas nën-paragrafit 1.4 të këtij neni marrin formën e një Aktgjykimi procedural të nxjerrë nga Dhoma e Posaçme, i cili nuk mund të apelohej.” Vendimet e Presidiumit, rregullat dhe udhëzimet e tjera duhet të publikohen në webfaqen e DhPGjS, mirëpo deri tash nuk janë publikuar.



me Kryetarin e KGjK-së. Ajo që është përmendur shpesh si kritikë në lidhje me punën e Presidiumit është tejkalimi potencial i kompetencave sa i përket rregullave procedurale. Kjo për shkak të nxjerrjes së rregullave të cilat bien ndesh me formulimin eksplisit të Ligjit apo hartimit të dispozitave thelbësore që për nga natyra janë dispozita që i rregullon ligji dhe jo rregullat procedurale. Për më tepër, brenda përbërjes së Gjykatës, ekzistojnë dy linja të ndryshme qëndrimi sa i përket nevojës së ekzistimit të këtij trupi.

Më konkretisht, një grup gjyqtarësh brenda Gjykatës argumenton se për sa kohë që DhPGjS është pjesë e Gjykatës Supreme, prania e një trupi të tillë (Presidiumit) jo vetëm se rezulton e panevojshme por mbi të gjitha është një arsye më tepër në krijimin e premisave për trajtim të ndarë dhe jo si pjesë përbërëse e Gjykatës Supreme. Kompetencat e këtij organi nuk janë mjaftueshëm të qarta në ligjin aktual dhe shpeshherë përmes rregullave procedurale të miratuara nga ky trup, ka rezultuar me ngecje të mëtejshme të proceseve në këtë gjykatë.

Një ndër objektivat dhe qëllimet e këtij koncept-dokumenti është që të identifikojë fushat problematike në fushëveprimin e DhPGjS dhe për të njëjtat të propozojë alternativa me synim final krijimin e një ligji që garanton rritjen e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së kësaj Gjykate. Rrjedhimisht, nëse ekzistenca e një trupi brenda gjykatës kontestohet nga një pjesë e vet gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe për më tepër shton konfuzitet dhe kolizion në kompetenca sa i përket organizimit të brendshëm, një opsion është që Presidiumi të shuhet si trup dhe puna e kësaj gjykate si rrjedhojë të harmonizohet sa më shumë me atë të Gjykatës Supreme. Në vend të Presidiumit, një propozim i ardhur është krijimi i postit të nën-kryetarit të DhPGjS.

Megjithatë, siç u cek më sipër, linja tjetër brenda Gjykatës mbron qëndrimin se puna e Presidiumit është e rëndësishme dhe thelbësore në mbarëvajtjen e punës së gjykatës. Kjo pasi përmes Presidiumit caktohen lëndët në kolegjet e specializuara, cakton rregulla procedurale apo vendos në rastet e kërkesave për përjashtimin e gjyqtarëve. Megjithatë, një pjesë e këtyre kompetencave pritet të shuhet apo ndryshohen substancialisht me ndryshimet e ligjit të gjithë këto kompetenca, siç është p.sh. caktimi i lëndëve në kolegje të specializuara. Nga ana tjetër, një pjesë e kompetencave të tjera të parapara për Presidiumin me Ligjin e DhPGjS, në një mënyrë apo tjetër, në gjykatat e tjera ushtrohen nga Kryetari i Gjykatës. Rrjedhimisht, Presidiumi si organ brenda DhPGjS ose duhet të shuhet në tërësi ose të rishikohen kompetencat dhe të ristrukturohet natyra e punës dhe rregullave që mund të nxjerrë. Cilido nga këto dy veprime ka si synim kryesor të rrisë efikasitetin dhe funksionalitetin e kësaj gjykate.

Në vijim, një çështje tjetër e cila është identifikuar kryesisht nga jurisprudenca e kësaj gjykate është juridiksioni i paqartë dhe i kufizuar sa i përket legjitimitetit të palëve në procedurë, pra paditësit dhe të paditurit. Në praktikë paditë e paraqitura nga Agjencia ndaj Komunave si palë e paditur janë hedhur poshtë si të papranueshme dhe/apo janë referuar në gjykata themelore. Në anën tjetër, Gjykatat Themelore çdo lëndë ku çështja ka të bëjë me prona shoqërore apo Agjencia është paraqitur si palë në procedurë e kanë referuar ne DhPGjS, duke u nisur nga juridiksioni ekskluziv i DhPGjS për të përcaktuar nëse një çështje bie nën fushëveprimin e saj. Kjo paqartësi jo vetëm se ka ndikuar në zvarritjen e paarsyeshme të procedurave, humbjen e besimit të qytetarëve për shkak të mungesës së informacionit preciz rreth statusit të lëndës dhe adresës së saktë për t'u drejtuar, por mbi të gjitha ka krijuar një konfuzitet në mënyrën e trajtimit të plotë të lëndëve të lartpërmendura.

Me qëllim të sqarimit të këtij konfuziteti të krijuar në praktikën e Gjykatës sipas nenit 4 të Ligjit për DhPGjS si më sipër, përcaktimi se cili përbën palë kundërshtare në procedurë para kësaj gjykate paraqitet si më se urgjent dhe i nevojshëm.

Më tej, një ndër problematikat e referuara nga palët e interesit sa i përket Ligjit aktual për DhPGjS janë edhe procedurat e përcaktuara me këtë Ligj, që dallojnë ndjeshëm sa i përket procedurave të parapara me Ligjin për Procedurën Kontestimore (referuar më tej si "LPK"). Një nga çështjet e adresuara këtu janë afatet në procedurë, që nga disa aktorë vlerësohet si të tejkujtura, kryesisht duke iu referuar procedurës me shkrim. Këto afate konsiderohen edhe si faktor tjetër që ka ndikuar në menaxhimin jo efikas të procedurave dhe grumbullimin e lëndëve të pazgjdhura. Andaj një çështje që paraqitet për diskutim janë afatet dhe nëse të njëjtat duhet apo mundet të harmonizohen me LPK. (p.sh. afati për paraqitjen e përgjegjës në padi në ligj e quajtur si "Mbrojtje" është 1 muaj, ndërsa afati për përgjigjen ndaj Mbrojtjes është 15 ditë, afat i njëjtë ky edhe për kundërpërgjigjen) Nga afatet e përcaktuara me Ligjin për DhPGjS rezulton se procedura me shkrim zgjat minimum dy muaj. Nga ana tjetër, sipas LPK-së, afati për përgjigje në padi është 7 ditë, dhe me LPK parashihet dërgimi i përgjigjes në padi i cili afat është po ashtu 7 ditë. Po ashtu afati për "Apel" ndaj aktgjyqimeve/aktvendimeve të DhPGjS-së është 21 ditë, ndërsa në LPK ky afat është 15 ditë.

Afati për lëshimin apo nxjerrjen e aktgjykimit/aktvendimit të DHPGJS është 60 ditë nga përfundimi i procedurave me shkrim apo verbale (nëse mbahen të tilla). Megjithatë, në qoftë se tejkalohe ky afat, gjyqtari apo Kolegji përkatës nuk ka detyrë të njoftojë Kryetarin, ndonëse në praktikë mund të ketë raste të tilla. E kundërta është me LKP, ku afati për nxjerrjen e vendimit është 15 ditë dhe po që se gjyqtari e kalon këtë afat, ai ka për detyrë që me shkrim ta njoftojë kryetarin e gjykatës për shkaqet e tejkalimit.

DhPGJS ballafaqohet me një vëllim shumë të madh të lëndëve të pazgjidhura, e që njëherit paraqet një ndër sfidat kryesore që nga themelimi e deri më sot. Vetëm në fund të vitit 2016 numri i lëndëve të pazgjidhura të raportuara është 21581. Për vitin 2017 rezultojnë 21300 lëndë<sup>6</sup>, ndërsa numri i lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2017 është 2577 lëndë.

Duke pasur parasysh përbërjen e tanishme të gjykatës, organizim e kolegjeve me përbërje të detyrueshme të një anëtari nga radhët e gjyqtarëve ndërkombëtar/EULEX si dhe duke e krahasuar numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë viteve paraprake dhe lëndëve të pazgjidhura, vlerësohet se DhPGJS do t'i duhen edhe 9-10 vite për t'i zgjidhur këto lëndë të grumbulluara, pa llogaritur lëndët e reja të cilat vazhdojnë të pranohen.

Në numrin e lëndëve të pazgjidhura një problem tjetër është sistemi i menaxhimit të lëndëve. Ndër këto, më shqetësues si faktor është duplikimi i rasteve të regjistruara, pasi në praktikën e DHPGJS regjistrohen si lëndë të ndara në panele të ndryshme duke u nisur nga kompetenca primare e kolegjit. Kështu p.sh. një lëndë e cila fillimisht është regjistruar në Kolegjin e Specializuar që merret me kërkesa që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore, pas fillimit të procesit të likuidimit të ndërmarrjes ndaj të cilës është drejtuar kërkesa, pezullohet procedura, paditësi udhëzohet që t'i drejtohet Autoritetit të Likuidimit me kërkesën apo pretendimin e tij. Për qëllime statistikore, DhPGJS këto lëndë i evidenton si të mbyllura ndërsa pasi Autoriteti i Likuidimit të lëshojë një vendim, i njëjti më pas mund të apelohe në DHP, e cila e regjistron si lëndë të re (me numër tjetër).

Në këtë rast procedura në lëndën e pezulluar mbetet edhe më tutje e pezulluar, ndërsa lënda regjistrohet në Kolegjin e Specializuar që ka kompetencë ekskluzive për rastet që kanë të bëjnë me likuidimin e një ndërmarrje apo pasurive të saj. Përkundër udhëzimeve të Presidiumit që për qëllime statistikore lëndët e pezulluara të evidentohen si të mbyllura, e njëjta bie ndesh pasi së pari ato janë të pezulluara dhe jo të përfunduara dhe njëkohësisht është vënë re se në praktikë rezulton me duplikim të numrit të lëndëve të regjistruara pranë Gjykatës. Së fundmi, praktika e Gjykatës ka filluar që të identifikojë rastet të tilla dhe të bashkojë të dy lëndët në një, kryesisht në atë të fundit, duke fshirë apo çregjistruar nga regjistri numrin e lëndës së parë. Mirëpo kjo bëhet vetëm me Vendim apo Urdhër të Gjykatës, pas informimit edhe të Presidiumit, çka në fakt mund të marrë kohë.

Për më tepër, në praktikë ekziston një numër i madh i lëndëve të cilat ende nuk janë pezulluar edhe pas fillimit të likuidimit të ndërmarrjes. Neni 10 i Shtojcës së Ligjit për

---

<sup>6</sup> Raporti i Përgjithshëm Vjetor – KGJK (2017)

AKP-në parasheh se çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo aseteve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatës.

Ligji po ashtu parasheh që procedurat e pezulluara mund të vazhdojnë apo të jenë në fuqi vetëm me leje të Autoritetit të Likuidimit apo të Gjykatës. Ndonëse për lejen nga Autoriteti i Likuidimit apo Gjykata nevojitet së pari dorëzimi i një kërkesë për lejimin e vazhdimit të procedurës, në ligj po ashtu nuk është përcaktuar ndonjë afat brenda të cilit Autoriteti i Likuidimit apo Gjykata do të duhej të merrte vendim për vazhdimin e procedurës së pezulluar. Me nenin 39 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parashihet afati (jo më vonë se 30 ditë pas vlerësimit të të gjitha kërkesave nga Autoriteti i Likuidimit) për publikimin e listave përfundimtare të kërkesave, mirëpo Ligji për AKP-në nuk përcakton ndonjë afat për vlerësimin e kërkesave nga Autoriteti i Likuidimit.

Vlen të theksohet se çfarëdo ndryshimi eventual në këtë ligj duhet bërë duke marrë në konsideratë dhe gjendjen dhe ndikimin që mund të kenë në strukturën e ndërlidhur ligjore, përfshirë këtu Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

#### **1. Përmasat e ndikimit;**

Ngarkesa shumë e madhe e gjykatës me lëndë, i prek mbi 21000 palë të ndryshme të ndërlidhura me këto lëndë. Më konkretisht, palët në procedurë janë ish punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore (më tej e referuar si "N.Sh.") që kërkojnë të përfshihen në listat e pjesëmarrësve nga 20%-shi i të ardhurave të privatizimi -i N.Sh.-ve, paga të pa paguara të punëtorëve nga N.Sh.-të, kërkesat tjera të punëtorëve apo kreditorëve tjerë të N.Sh.-ve, pretendime pronësore ndaj aseteve të N.Sh.-ve, pretendime për shkelje të rregullave tenderuese gjatë shitjeve në privatizim apo likuidim, ankesat e paraqitura në procedurën e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Ish-punëtorët e N.Sh.-ve janë kategoria e cila pëson më së shumti nga nga kjo ngarkesë e gjykatës me lëndë, por gjithashtu edhe kreditorët/ e tjerë me kërkesa kundrejt N.Sh.-ve dhe/apo AKP-së. Duke qënë se N.Sh.-të gjenden në të gjitha rajonet, ngarkesa e gjykatës me lëndë i prek të gjitha rajonet e territorit të Republikës së Kosovës.

Nga ky problem preken organizata të ndryshme sindikale të punëtorëve, AKP, ndërmarrjet shoqërore dhe organizata të ndryshme të biznesit.

Përmasat dhe Kohëzgjatja e Problemit/Zotimit					
	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti
Numri i njerëzve / incidenteve /organizatave	2003	Xx	xx	xx	2016

### *Politika aktuale*

1. Shpjegoni politikën e cila zbatohet aktualisht. Përshkruani instrumentet e politikave që janë aktualisht në përdorim. Shpjegoni kush është përgjegjës – një ministri, organizatë tjetër, sektori privat ose në mënyrë vullnetare. Shënoni organizatat që janë përgjegjëse për këtë çështje.

Prej vitit 2002 deri në korrik të vitit 2008, DhPGjS-ja ka vendosur vetëm në rastet e ndjeshme apo të caktuara, duke i referuar një numër të konsiderueshëm të lëndëve pranë Gjykatave Komunale. Që nga themelimi i saj me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/13 e deri më tani, DhPGjS ka pasur kompetencë ekskluzive për të gjitha çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Mirëpo, përgjatë periudhës së funksionimit nën Rregulloren nr. 2002/13, DhPGjS kryesisht ka referuar lëndën me elemente pronësore në gjykatat komunale. Me hyrjen në fuqi të ligjit aktual, dispozitat përcaktonin obligim për transferim të të gjitha atyre lëndëve të bartura më parë në gjykata komunale sërish pranë DhPGjS.. Kjo ka rezultuar në një fluks të madh të lëndëve (rreth 2.000 lëndë të bartura nga gjykatat komunale në vitin 2012) në DhPGjS.

Në vitin 2009, AKP-ja filloi të shpallë një numër të madh të listave të punëtorëve me të drejtë pjesëmarrjeje në 20% nga të hyrat e privatizimit të N.Sh.-ve, duke rezultuar në një numër të lartë të ankesave të punëtorëve të cilët paraqitën ankesa për shqyrtim panë Gjykatës (prej vitit 2009 deri më tani janë më shumë se 12.000 ankesa).

Më 10 korrik 2012, AKP-ja ka kontraktuar një konzorcium për ofrimin e shërbimeve profesionale për likuidimin e një portofoli të N.Sh.-ve. Me hyrjen në likuidim të një numri të madh të N.Sh.-ve, është shumëfishuar numri i vendimeve të lëshuara nga Autoritetet përkatëse të Likuidimit. Të gjithë vendimet refuzuese parashohin Ankesën pranë DhPGjS si mjet juridik. Rrjedhimisht ka pasuar edhe një rritje e konsiderueshme e numrit të lëndëve të regjistruara si pasojë e ankesave të parashtruara pranë DhPGjS-së. Prandaj, vëllimi i lëndëve në pritje për t'u zgjidhur është rritur dukshëm që nga viti 2013 (15.000

raste të regjistruara prej vitit 2013 deri më sot). Lëndët e likuidimit të parashtruara prej vitit 2013 përbëjnë 66% të gjitha lëndëve në pritje.

Rezultati i lëndëve të përfunduara është i kufizuar nga kapaciteti i DhPGjS-së dhe ka qenë pak a shumë i qëndrueshëm në vitet e fundit (DhPGjS-ja përmbyll përafërsisht 2200 lëndë në vit).

KGJK-ja në bazë të Ligjit mbi gjykatat dhe Ligjin për Këshillin gjyqësor të Kosovës, është drejtpërdrejtë e autorizuar dhe përgjegjëse për zbatimin e politikave të menaxhimit të gjyqësorit të Kosovës dhe të krijimit të kushteve për punë të gjykatave, e në këtë kontekst edhe të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

KGJK-ja politikën e menaxhimit të punës së gjykatave, e realizon duke nxjerr akte nënligjore të rangut të Rregulloreve, Udhëzimeve administrative, vendimeve dhe memorandumëve të ndryshme, me të cilat akte rregullon autoritetin menaxhues ndaj gjykatave, e në këtë kontekst edhe ndaj Dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme.

## **2. Shpjegoni përgjegjësinë e secilës organizatë të përfshirë.**

KGJK-ja e ka përgjegjësinë e zbatimit të politikave dhe të aktiviteteve ,që mundësojnë krijimin e kushteve më të mira për punë të Dhomës së Posaçme. Masat dhe aktivitetet e KGJK-së duhet të shtrihen në të gjitha fushat e përgjegjesisë së tij të përcaktuara me ligj për të siguruar që Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme të ketë kushte më të mira për punë.

Ligji Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ne nenin 15 ka përcaktuar:

1. Në konsultim me Kryetarët e Gjykatave, Këshilli propozon buxhetin vjetor operues të Këshillit dhe të gjykatave. Këshilli i dërgon buxhetin drejtpërsëdrejti Qeverisë siç ceket me ligj. Nëse ministri i Ekonomisë dhe Financave dërgon një buxhet për Këshillin dhe gjykatat, i cili ndryshon nga ai që është propozuar nga Këshilli, Ministri i Ekonomisë dhe Financave po ashtu do t'i dërgojë për konsiderim Kuvendit të Kosovës buxhetin e rekomanduar në fillim nga Këshilli dhe çfarëdo komenti mbi këtë.

2. Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për Këshillin dhe gjykatat në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimit të fondeve dhe mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale dhe kryerjen e auditimeve financiare”.

Ndërsa Ligjin Nr. 05/L -033 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës në Nenin 9 e ndryshon Nenin 15 të ligjit bazik, paragrafi

1 riformulohet me tekstin si në vijim: “1. Këshilli përgatit propozimin e buxhetit vjetor dhe ia dërgon propozimin e tillë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës”

### **3. Shpjegoni se çfarë është bërë deri më tani për këtë çështje.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme në bazë të rekomandimit të Avokatit të popullit të dhënë në raportin e tij nr.44/2017 të datës 31 janar 2017, ka hartuar Strategjinë për reduktimin e lëndëve të grumbulluara, ka ndërmarrë masa që me resurset e kufizuara njerëzore që i ka për aq sa është e mundur ta kontrolloj gjendjen jo të mirë që ekziston në këtë Gjykatë një kohë të gjatë.

KGJK-ja së bashku me Gjykatën Supreme, kanë marrë disa masa jo të mjaftueshme, që kanë ndikim por nuk mundësojnë zgjidhjen e problemit. Një ndër çështjet që më parë është ngritur si shqetësim ishte edhe numri i dokumenteve për përkthim. Megjithatë, aktualisht, pas kontaktimit të një kompanie private që merret me përkthimin e dokumenteve më pak senzitive, numri i dokumenteve në pritje është shuar. Njësia aktuale e përkthimeve të dokumenteve e Dhomës së Posaçme megjithatë ka mangësi, kryesisht në lidhje me shtimin e stafit profesional dhe administrativ. Pesë pozita të stafit profesional mbi një vit e gjysmë ende nuk plotësohen. Ngjashëm, çështje e ngritur është edhe hapësira ekzistuese për punë, e cila konsiderohet si e pamjaftueshme.

Pas decentralizimit të përgjegjësive nga KGJK-ja në Gjykatën Supreme në fushën e financave, logjistikës, prokurimit dhe të personelit, Gjykata Supreme në këto fusha në bazë të një Udhëzimi administrativ të KGJK-së e ka përgjegjësinë edhe për Dhomën e Posaçme. Përgjegjësit në këto fusha sidomos në atë të personelit nuk janë kryer në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe kjo ka dhe do të këtë ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e punës e Dhomës së Posaçme.

### **4. Shpjegoni përpjekjet e mëparshme për zgjidhjen e problemit ose përmbushjen e zotimit. Shpjegoni se çka ka ndodhur.**

DHPGJS-ja ka bërë përpjekje për zvogëlimin e ngarkesës së madhe që e ka gjykata me lëndë, mirëpo rezultatet e arritura nuk kanë mundur të ndikojë ndjeshëm në zgjidhjen e problemit. Ndonëse janë provuar ndarja më efikase e lëndëve në panelet e ndryshme të gjykatës si dhe regjistrimi sa më efikas dhe i saktë i lëndëve të reja, situata vazhdon të jetë e rënduar. Po ashtu, ndonëse është shuar numri i dokumenteve të papërkthyer, vazhdojnë të paraqiten lëndë të reja që ndërkohë duhen përkthyer për t'u procesuar më pas nga kolegji përkatës.

Ngjashëm, numri i bashkëpunëtorëve profesional vazhdon të jetë çështje shqetësuese, ndonëse është premtuar vazhdimisht rritja e numrit të tyre

Zotimet e KGJK-së për mbështetje më të madhe që i është nevojitur DHPGJS-së, gjithëherë dhe në mënyrë efektive nuk janë përmbushur. Përkundër përpjekjeve të bëra nga faktorët e brendshëm në DHPGJS, nga viti në vit numri i lëndëve të pazgjidhura është rritur.

**Ligjet dhe aktet nënligjore të cilat ndërlidhen me këtë problem/çështje, janë te listuara me poshtë:**

**Ligji Nr.03L 223 Për KGJK-në**

Rregullon organizimin dhe funksionet e Këshillit duke përfshirë procedurat për rekrutim, emërim, riemërim, transferime, disiplinë, vlerësim, ngritje në detyrë dhe trajnim të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; duke përfshi propozimin të Presidentit për emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin

Me dispozitat e ligjit për KGJK-në në përbërjen të këshillit parashihen dy gjyqtarë të Gjykatës Supreme, të zgjedhur nga gjyqtarët e Gjykatës Supreme por nuk sigurohet shprehimisht një përfaqësim i gjyqtarëve të DHPGJS-së në vendimmarrjen e KGJK-së.

Përfaqësimi aktual i DHPGJS-së në KGJK bëhet mbi bazën e ligjit mbi gjykatat, e cila përcakton se DHPGJS-ja është pjesë e Gjykatës Supreme, dhe ky përfaqësim i DHPGJS-së është siguruar me një vendim të KGJK-së për zgjedhjen e anëtarëve të KGJK-së nga radhët e Gjykatës Supreme, dhe këtë vetëm kur para disa muajsh janë zgjedhur anëtarë të Këshillit gjyqësor nga radhët pjesës së gjyqësorit një gjyqtar i Gjykatës Supreme dhe një gjyqtare e DHPGJS-së. Kjo ka ndodhë para disa muaj, ndërsa më herët në historinë 13 vjeçare të veprimit të DHPGJS-së, asnjëherë DHPGJS-ja me gjyqtarët e vet nuk është përfaqësuar në KGJK. Përfaqësimi i DHPGJS-së në KGJK edhe në bazë të ligjit, siguron që KGJK-ja më lehtë të njoftohet me të gjitha sfidat që përballet DHPGJS-ja, dhe kjo mundëson të shtrohen për shqyrtim dhe zgjidhje problemet e shumta me të cilat përballet DHPGJS-ja.

Përfaqësimi i DHPGJS nuk është siguruar as në Asamblenë e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës i cili është paraparë si organ këshillëdhënës për të këshilluar Këshillin mbi çështjen që ndërlidhen me veprimet e gjykatave. Ligji përcakton që Asambleja përbëhet nga Kryetari i Gjykatës Supreme, Kryetari i Gjykatës së Apelit,



Kryetarët e Gjykatave Themelore dhe një Gjyqtar Mbikëqyrës nga secila Gjykatë Themelore që caktohet nga Këshilli.

Një ndër problemet e identifikuara me këtë formë të funksionimit të Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave është fakti se në të mungon përfshirja shprehimisht dhe përfaqësimi i Kryetarit të DhPGjS. Si rrjedhojë, jo vetëm se DhPGjS mbetet pa zë në këtë Asamble mirëpo një anashkalim i tillë i përfaqësimit, pra në mungesë të referimit shprehimisht të Kryetarit të DhPGjS si pjesë përbërëse e kësaj Asambleje, e njëjta shkakton edhe më tej ndarje dhe rivalitet ndërmjet DhPGjS dhe Gjykatës Supreme. Duke qenë se DhPGjS, sipas Ligjit për Gjykatat, është pjesë e Gjykatës Supreme, mirëpo nga ana tjetër funksionon ndaras dhe ka një strukturë dhe hierarki organizative të posaçme dhe si rrjedhojë ka të sanksionuar edhe postin e Kryetarit të kësaj gjykate, nevojitet harmonizim i dispozitave përkatëse.

#### **Ligji Nr. 03L/199 për Gjykatat**

Rregullon organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e gjykatave në Republikën e Kosovës.

Sa i përket strukturës organizative dhe kompetencës së gjykatave ligji përcakton se Gjykata Supreme përfshin Kolegjin e Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e së cilës janë pjesë e Gjykatës Supreme. Rrjedhimisht kushtet ligjore që duhet ti plotësojë një kandidatë për tu zgjedhur gjyqtar i DHPGJS janë të njëjta ma kushte për emërimë në Gjykatën Supreme për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme, gjyqtari duhet të ketë (përveç kualifikimeve minimale 3 vite përvojë në fushën juridike) së paku tetë (8) vite përvojë si gjyqtar. Po ashtu parashihet që paga e Gjyqtarit i Gjykatës Supreme do të jetë në shkallë prej nëntëdhjetë përqind (90%) të pagës së Kryetarit të Gjykatës Supreme.

Duke qenë se sipas Ligjit për Gjykatat, DhPGjS ka qenë dhe mbetet pjesë e Gjykatës Supreme, paraqitet nevoja që të integrohen dhe të harmonizohen në mënyrë analoge dispozitat përkatëse për kryetarin e Gjykatës Supreme edhe për kryetarin e DhPGjS-së.

Andaj, dispozitat aktuale të Ligjit mbi Gjykatat sidomos në raport me DhPGjS e që ndërlidhen me kushtet që duhet plotësuar një kandidat për tu zgjedhur gjyqtar i DHPGJS-së, ka nevojë të rishikohen dhe të adaptohen në pajtim me rrethanat, në mënyrë që kur të zbatohet Ligji i Dhomës së Posaçme i cili duhet të pësoj ndryshime që lejon rritjen e numrit të gjyqtarëve, të sigurohet që të mos ekzistojnë diskrepanca ndërmjet kriterit të përvojës së punës për gjyqtar në DhPGjS dhe atyre në Gjykatën Supreme dhe

gjithashtu të mos ketë vështirësi të mëdha në sigurimin e kandidatëve që shprehin interesim të aplikojnë për gjyqtar të DHPGJS-së. Plotësimi i shpejtë dhe i lehtë i pozitave të reja për gjyqtar, që do të mundësojë ndryshimi i Ligjit për Dhomën e Posaçme, ka ndikim esencial në reduktimin e lëndëve të grumbulluara dhe në zgjidhjen e tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Me dispozitat e Ligjit për Gjykatat garantohet qasja në gjykatë (neni 7), çdo personi fizik dhe juridik u garantohet qasje dhe mbrojtje e barabartë në gjykatë, garanton gjykim të drejtë në përputhje me ligj dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor, të drejtën në mjete efektive ligjore, publicitetin e seancave, funksionimin e gjykatave në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.

### **Rregullore e KGJK-se nr. 09/2016**

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e zgjedhjes, emërimit, vlerësimit, pezullimit dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, kriteret për kandidat.

Me nenin 8 të Rregullores përcaktohet se KGJK-ja pas votimit i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimin e:

- kandidatit të përzgjedhur për kryetar të Gjykatës Supreme; dhe
- emëron kryetarin e Gjykatës së Apelit, kryetarët e gjykatave themelore dhe gjyqtarët mbikëqyrës të degëve.

Me këtë rregullore nuk parashihet emërimi i Kryetarit të DHPGJS.

### **Rregullore e KGJK-se nr. 2013 për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave**

Përcakton organizmin, menaxhimin dhe veprimtarinë e gjykatave në Republikën e Kosovës e cila zbatohet në Gjykatën Supreme duke përfshirë Kolegjin e Apelit të Agjencia Kosovare e Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Gjykatën e Apelit, Gjykatat Themelore si dhe degët e Gjykatave Themelore në Republikën e Kosovës.

Neni 4 i përcakton përgjegjësitë e kryetarit të gjykatës, të administratorit, Kolegjiut të gjyqtarëve, Kolegjiut të gjyqtarëve të gjykatës Supreme përbëhet nga të gjithë gjyqtarët e kësaj gjykate dhe kryesohet nga kryetari i gjykatës. Organizimin e administratës së gjykatës dhe zyrës së menaxhimit të lëndëve përfshi regjistrimin, caktimin, mbajtjen e regjistrave.

**Rregullore e UNMIKUT nr. 2003/13 (09/05/2013), Mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore.**

Përmes së cilës çfarëdo e drejtë për përdorimin e pronës së regjistruar në emër të një ndërmarrjeje në pronësi shoqërore, e cila i është transferuar një korporate filial i ndërmarrjes në pronësi shoqërore (në përputhje me nenin 8 të Rregullores 2002/12) shndërrohet në qira. Me këtë rregullore po ashtu parashihen të drejtat e të punësuarve në ndërmarrje shoqërore, për shkak të ndikim që mund të ketë procesi i privatizimit në statusin e tyre u njihet e drejta që të përfitojnë 20 % e të ardhurave nga shitja e aksioneve të një filiali korporate në varësi të një ndërmarrjeje me pronësi shoqërore që është privatizuar. Me këtë rregullore parashihet edhe e drejta në ankesë ndaj vendimeve të Agjencisë në DHP brenda afatit prej 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare të listës nga Agjencia, dhe parashihet që këto ankesa duhet të shqyrtohen nga DHP në bazë të përparësisë brenda 40 ditëve pas dorëzimit të tyre.

**Ligji Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

(I ndryshuar dhe plotësuar me Ligji nr. 05/1-080 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/1-034 për AKP-në, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/1-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjë me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës), themelon Agjencinë si një organ i pavarur publik, njëherit si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, e autorizuar për administrimin - duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidikimin - e ndërmarrjeve dhe asetëve të përkufizuara në këtë ligj.

Agjencia si person juridik ka zotësi të plotë juridike, dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Bordi i Drejtorëve të Agjencisë nxjerr politikën operative për udhëheqjen e Agjencisë në ushtrimin e kompetencave të saj.

Ligji përcakton ndërmarrjet dhe asetet nën autoritetin administrativ të Agjencisë e që janë: - ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo;

- të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose pas 22 Marsit 1989, përveç rasteve të tjera të rregulluara me ligj (paragrafi 2. të këtij neni)

- të gjitha aksionet në korporata dhe korporatat vartëse të themeluara sipas këtij ligji; dhe të gjithë interesat në pronësi shtetërore në një ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik, pavarësisht nëse ajo ndërmarrje apo subjekt juridik i është nënshtruar transformimit.

përfshirë pronat që gjenden jashtë Kosovës (te kufizuar sipas ligjit) deri në masën që Agjencia e konsideron të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën dhe qasjen ndaj këtyre pronave dhe kufizimet e burimeve administrative të Agjencisë.

Me neni 29 të Ligjit përcaktohen të drejtat e Agjencisë në procedurat ligjore kundër ndërmarrjeve kërkuesi obligohet të siguron dëshmi me shkrim se Agjencia e konsideron të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën dhe qasjen ndaj këtyre pronave dhe kufizimet e burimeve administrative të Agjencisë. Me nenin 30 të Ligjit për AKP-në parashihet se në të gjitha paditë gjyqësore kundër Agjencisë Dhoma e Posaçme ka juridiksion ekskluziv dhe se Dhoma e Posaçme nuk do të pranojë asnjë padi kundër Agjencisë përveç nëse pala paditëse dorëzon dëshminë se e ka njoftuar kryesuesin e Bordit për dorëzimin e një padie të tillë së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para dorëzimit të saj. Me kërkesën e Agjencisë Dhoma e Veçantë mund të pezullojë hapjen e procedurës së padisë që është bërë kundër Agjencisë për një afat i cili nuk mund t'i kalojë gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e pranimit të padisë së tillë për të mundësuar një zgjidhje miqësore.

Po ashtu me Ligjin për DHP (neni 6) parashihet se ç'do ankesë apo kërkesë duhet të përcillet me këto prova, dhe se DHP nuk do të pranojë kërkesën apo ankesën e tillë e cila nuk përcillet me këto prova.

**Me Shtojcën e Ligjit për AKP-në** përcaktohen bazat dhe procedurat për likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Aseteve mbi të cilat Agjencia ka autoritet, në pajtim me Ligjin për AKP-në dhe të drejtat dhe obligimet e të gjithë pjesëmarrësve dhe palëve të prekura.

Procedura për likuidimin e një ndërmarrje inicohet me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Bordi përcakton personat e autorizuar që të veprojnë si Autoritet i Likuidimit i një Ndërmarrje në procedurë të likuidimit. Agjencia obligohet të bëjë publikimin e njoftimit për likuidim brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së Vendimit për likuidim. (neni 7). Njoftimi duhet të përfshijë një deklaratë se të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interesa ndaj ndërmarrjes apo asetëve të ndërmarrjes duhet të parashtrorjnë Dëshmi të Kërkesës dhe/apo Dëshmi të Interesit me anë të formularët përkatës bashkë me të gjitha dokumentet mbështetëse brenda afatit prej dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është publikuar Njoftimi pavarësisht nëse më herët e kanë informuar Gjykatën, Agjencinë apo pararendësin e Agjencisë (Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit) në lidhje me të. Njoftimi po ashtu parasheh një deklaratë për Kërkesat dhe

Interesat që nuk janë parashtruar si duhet deri në Afatin për parashtrimin e kërkesave do të refuzohen dhe do të jenë përgjithmonë të parashkruara dhe të pa ekzekutueshme.

Brenda pesëmbëdhjetëmijë (15) ditësh pas publikimit fillestar të Njoftimit për likuidim, Autoriteti i Likuidimit publikon përsëri njoftimin në pajtim me Dispozitat për shpallje dhe me nenin 9 para 3 parashihet që çfarëdo padie gjyqësore kundër një ndërmarrje e cila është subjekt i likuidimit do të pezullohet me rastin e paraqitjes së kërkesës nga Agjencia në gjykatën e vendit ku është paraqitur padia.

Ndërsa me nenin Neni 10 Pezullimi i çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit nga Agjencia.

Me nenin 24 është siguruar mbrojtja e interesave të kreditorëve me ç' rast kreditorët mund të kreditorët e regjistruar të një ndërmarrje mund të parashtrojnë kërkesë në Gjykatë për lëshimin e një urdhri sipas të cilit afarizmi apo asetet e ndërmarrjes janë menaxhuar nga Autoriteti Likuidues në mënyrë që është padrejtësisht paragjykuese ndaj interesave të kreditorëve. Gjykata do të marr vendim mbi të gjitha kërkesat e tilla jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas datës së parashtrimit të kërkesës.

Me nenin 39 parashihet afati (jo më vonë se 30 ditë pas vlerësimit të të gjitha kërkesave) për publikimin e listave përfundimtare të kërkesave, mirëpo nuk parashihet ndonjë afat për vlerësimin e kërkesave nga Autoriteti i Likuidimit.

### **Ligji Për Trepçën (Nr. 05/L -120)**

Ky ligji përcakton transformimin e njësive biznesore të Trepçës në Shoqëri Aksionare Trepça Sh.A. Resurset Minerale konsiderohen pronë e Republikës së Kosovës Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e 80% të aksioneve të Trepça Sh.A. ndërsa Pronarë të 20% të aksioneve të Trepça Sh.A. janë punëtorët.

Ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore e cila synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes hapjes së rrugës për investime, rritjen e vlerës së asetëve dhe avancimin e kapitalit tekniko teknologjik si parakusht për rivitalizimin e Trepçës si një ndërmarrje me rëndësi të veçantë, jetike për mirëqenien sociale të punëtorëve dhe interesin e përgjithshëm publik.

Ligji përcakton se asetet të cilat nuk transformohen me këtë ligj do të trajtohen sipas rekomandimeve të studimit të fizibilitetit. Asetet jothelbësore dhe joprofitabile do të mbeten në menaxhim të AKP-së për t'iu nënshtruar privatizimit ose likuidimit në përputhje me ligjin.

**Ligji Nr. 04/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -008 (2015)**

Përcakton rregullat dhe procedurat për riorganizimin dhe likuidimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe asetëve dhe obligimeve të tyre nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për ta mundur rehabilitimin e këtyre ndërmarrjeve dhe rikthimin e qëndrueshmërisë së tyre si biznese të vazhdueshme dhe për t'i sjellë përfitime ekonomisë së Republikës së Kosovës

Procedurat e riorganizimit apo likuidimit të këtyre Ndërmarrjeve do të udhëhiqen nga Dhoma e Posaçme, vetëm për ndërmarrje të caktuara për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit ka paraqitur kërkesë për riorganizim pranë Dhomës së Posaçme.

Ne baze të kërkesës, gjykata merr vendim (Vendimit të Moratoriumit) me të cilin të gjitha veprimet, procedurat apo aktet e çdo lloji që kanë për qëllim përcaktimin e vlefshmërisë, zbatimin apo përmbushjen e ndonjë kërkesë apo interesi ndaj Ndërmarrjes në fjalë apo Aseteve të saj do të pezullohen dhe do të vazhdojnë vetëm me lejen e gjykatës, përfshirë veprimet, procedurat apo vendimet gjyqësore.

Pas publikimit të parë të njoftimit të Moratoriumit jo më vonë se treqindëgjashtëdhjetë (360) ditë Administratori do të publikojë një tjetër njoftim të quajtur "Njoftimi për Afatin e Kërkesave" se të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo Interesa ndaj një Ndërmarrjeje apo asemi të saj ftohen t'ia parashirojnë Dëshmitë e Kërkesave dhe/apo Dëshmitë e Interesit brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditë dhe jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së publikimit të Njoftimit për Afatin e Kërkesave.

Agjencia do të shërbejë si Administrator i Ndërmarrjes. Nga dita e Vendimit të Moratoriumit deri në datën e konfirmimit të riorganizimit. Administratori kërkon leje paraprake me shkrim nga Gjykata në mënyrë që Ndërmarrja të mund të realizojë ligjërisht transaksionet e përcaktuara me ligj, siç janë shitja, bartja, disponimi me prona të ndërmarrjes. Administratori mund të kërkojë nga gjykata lëshimin e urdhrave ndaj palëve të treta që shfrytëzojnë apo posedojnë një pasuri të ndërmarrjes të cilët edhe pas njoftimit refuzojnë që të heqin dorë nga shfrytëzimi apo posedimi dhe t'ia kthejnë pasurinë administratorit.

Gjykata do të marrë vendim për të gjitha kërkesat e parashtruara sipas paragrafit 1. të këtij neni, brenda jo më pak se njëzet (20) ditësh dhe jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditësh pas datës së parashtrimit të kërkesës në gjykatë Të gjitha palët që kundërshtojnë kërkesat në fjalë duhet të regjistrojnë shkresat e tyre brenda njëzet (20) ditësh pas pranimit të kërkesës.

Brenda 18 muajve pas datës së publikimit të Njoftimit, për afatin e parashtrimit të kërkesave administratori përgatit Planin e Propozuar për Riorganizim dhe e dorëzon atë para Komisionit të Kreditorëve. Një kopje e këtij plani i dorëzohet në të njëjtën kohë gjykatës. Gjykata mund të zgjasë periudhën prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh, në maksimum prej tridhjetegjashtë (36) muaj pas një apo më shumë kërkesave të dorëzuara në Gjykatë nga Administratori, përfshirë arsyet për një kërkesë të tillë. (neni 22 paragrafi 1 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet me nenin 2 të ligjit per ndryshim).

#### **Ligji Nr. 02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare**

Rregullon themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe shpërbërjen e llojeve të zakonshme të shoqërive tregtare.

#### **Ligji NR. 2002/ 4 Për Hipotekat**

Përcakton mjetet për krijimin e hipotekave, efektet e tyre ndërmjet palëve në një kontratë të tillë, efektet e tyre ndaj personave të tretë, dhe mjetet me anë të të cilave, hipotekat e shoqërive tregtare mund të ekzekutohen nëpërmjet procedurave jashtë-gjyqësore në rast të mos përmbushjes sipas kushteve të dokumentit të hipotekës

#### **Ligji Nr. 04/-L-013 Për Kadastër**

Rregullon kadastrin e palujetshmërive, matjet shtetërore dhe kadastrale, punët gjeodezike dhe kadastrale si dhe përfitimin, regjistrimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e të dhënave kadastrale.

#### **Ligji NR. 2002/ 5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme**

Me të cilin themelohet Regjistri i të drejtave të pronës së paluajtshme i cili administrohet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Të drejtat e pronave të paluajtshme siç janë pronësia, hipoteka, servitutet, të drejtat e shfrytëzimit të pronave të paluajtshme shoqërore dhe pronave shtetërore që i takojnë tokës, ndërtesave dhe banesave regjistrohen në regjistër. Me ligj rregullohet procedura e regjistrimit, dokumentacioni që kërkohet, procedura e marrjes së vendimit nga ZKK dhe shqyrtimit të vendimit si dhe mirëmbajtjes së Regjistrit.

#### **Ligji Nr. 02/L-26 Për Tokën Bujqësore**

Përcaktohet shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të veçantë të tokës bujqësore si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm.

#### **Ligji Nr. 04/L-144**

#### **Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin të Pronës së Paluajtshme të Komunës**

Rregullon mënyrën e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, këmbimin e pronës komunale me persona fizik dhe juridik, si dhe këmbimin e pronës me institucione qendrore dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Ligji përcakton se Komunitat kanë të drejtë për interes publik, kthimin e pronës së paluajtshme që përfshinë tokat e ish-Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat janë në territorin e Komunës dhe tani administrohen dhe menaxhohen nga AKP-ja (neni 12). Ndërsa me nenin 13 përcaktohen kushtet dhe procedurat për këmbimin e pronës komunale me pronësinë e menaxhuar nga AKP-ja.

#### ***Shpenzimet aktuale***

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak	Buxheti në këtë vit	KASH për vitin e ardhshëm
Buxheti i Ministrisë: (shëno secilin lloj të shpenzimit)			
Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit)			
Financimi nga donatorët			
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave			



### *Vlerësimi plotësues i politikës aktuale*

Aktualisht shumë dispozita të këtij ligji mund të interpretohen varësisht nga gjyqtari, e në rastin e Dhomës së Posaçme, varësisht nga përbërja e kolegjit. Kjo të lë të kuptosh se kemi zbrazëti të theksuara juridike në dispozitat e këtij ligji)

Politika aktuale rezulton si jo efektive pasi së pari nuk përcakton procedurat e zgjedhjes, shkarkimit dhe mandatin e Kryetarit etj. Po ashtu, e njëjta nuk parashikon mënyrën e emërimit të gjyqtarëve, përvojën e punës që është e njëjtë si për gjyqtarët në shkallë të parë edhe për Kolegjin e Apelit. Për punën e kësaj gjykata nuk parashihen me asnjë dispozitë mundësia e rekrutimit të bashkëpunëtorëve profesional, nuk parashihet në mënyrë të qartë mundësia e vendimmarrjes individuale, kur dhe si, për disa raste që mund të vendoset në mënyrë që të zgjidhen më shpejtë disa kërkesa apo ankesa.

Për shkak të kufizimeve të shpjeguara më lartë dhe përbërjes së kolegjeve që është imponuar me këtë ligj aktual si dhe për shkak të arsyeve të tjera të elaboruara më lartë në këtë koncept dokument.

Dhoma e Posaçme nuk ka asnjë burim vetanak financiar, por ç' do gjë varet nga Gjykata Supreme, gjegjësisht nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Problemet lindin në interpretim të dispozitave përkatëse, sepse ka shumë zbrazëti ligjore, edhe sa i përket kompetencës, përfaqësimit, pranueshmërisë së padisë dhe ankesës, kriterëve për njohjen e të drejtës në 20% sa i përket pezullimit apo mospezullimit të procedurës kur NSH-ja është në likuidim. etj. Problemi veçse vazhdon të theksohet dhe zmadhohet për shkak të arsyeve që janë cekur në pikat më lartë.

### *Përvoja në shtetet tjera*

Sa i përket çështjes se privatizimit për te cilat është kompetente Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, përvoja e shteteve tjera nuk mund të merret si përvojë në rastin e Kosovës, meqenëse shtetet e rajonit si p.sh, Mali i Zi Serbia, Polonia etj, kontestet e privatizimit janë shqyrtuar në kuadër të Gjykatave ekonomike si Gjykata të Rregullta.

### **Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat**

Synimi i përgjithshëm është forcimi i sundimit të ligjit në sistemin ligjor dhe gjyqësor, përforcimin dhe respektimin e të drejtave pronësore dhe rritja e zhvillimit ekonomik. Fushëveprimi i DhPGJS prek një sërë aktorësh, përfshirë këtu KGJK-në, AKP-në dhe qindra persona që janë palë në 21300 lëndë që janë aktualisht të pazgjidhura në këtë Gjykatë. Rrjedhimisht synimi kryesor përmes këtij koncept dokumenti është evidentimi nëse ka fusha apo hapësira ku DhPGJS ka hasur në problematika dhe ngecje të cilat nuk

mund të tejkalohen me bazën aktuale ligjore dhe identifikimi i mënyrave për zgjidhjen e tyre në mënyrë që të sigurohet funksionimi dhe organizimi i plotë, i mirëfilltë dhe efikas i kësaj Gjykate në kuadër të sistemit gjyqësor në Kosovë.

### *Objektivat*

#### **1. Shënoni së paku dy gjëra të matshme që duhet të arrihen.**

- a) Rritja e efikasitetit në zgjidhjen e kontesteve të regjistruara në Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme përmes lehtësimit të procedurave.
- b) Shqyrtimi i ndarjes apo kategorizimit të kompetencave brenda Kolegjeve të Gjykatës.
- c) Ndryshimi i përbërjes së Kolegjeve dhe ndryshimi i numrit të caktuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate.

**Specifike - përshkruani çfarë duhet të ndryshohet. Krijoni një lidhje ndërmjet problemit dhe objektivit.**

- Përmirësimi i kornizës ligjore për funksionimin e brendshëm të Gjykatës, duke marrë parasysh edhe harmonizimin me strukturën dhe organizimin nga KGJK-ja;
- Qartësimi i dispozitave lidhur me përbërjen e kolegjeve brenda DhPGJS;
- Heqja e kufizimit ligjor për numrin e caktuar të gjyqtarëve;
- Identifikim i kushteve bazë për pranueshmërinë e lëndëve në gjykatë dhe mënyra e shqyrtimit të pranueshmërisë së një lënde para se të regjistrohet në Regjistër;

#### **1 Matshme - sa do të ndryshojë. Përshkruani të gjitha gjërat që mund të maten ose numërohen.**

Numri i lëndëve të vjetra/të reja zgjidhura nga DHPGJS;

Ndarja e lëndëve në kolegje dhe delegimi për vendosje në nën-kolegje;

Numri i gjyqtarëve të emëruar dhe numri i anëtarëve në kolegje/nën-kolegje;

Mënyra e regjistrimit të lëndëve - formula dhe numri i saktë/real i lëndëve në pritje.

#### **2 Pranueshme - Objektivi duhet të jetë i arsyeshëm në raport me çështjen. Shpjegoni lidhjen ndërmjet objektivit dhe prioriteteve të Qeverisë ose strategjisë së përgjithshme.**

Propozimet e ofruara përputhen me objektivat dhe programin/prioritet e Qeverisë për forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë dhe funksionalizimin dhe efikasitetin e punës pranë kësaj Gjykate.

**3 Reale – objektivi duhet të jetë i arritshëm. Siguroni që objektivi të jetë i arritshëm.**

Objektivat e përcaktuara janë të arritshme duke marrë parasysh analizën dhe rekomandimet e ofruara përmes këtij koncept dokumenti.

**4 Afatizuar – siguroni që objektivi të mund të arrihet brenda një afati të caktuar kohor.**

Këto objektiva mund të arrihen në gjashtë mujorin e parë të vitit 2018.

#### **Kapitulli 4: Opsionet**

##### *Opsioni 1: Opsioni status-quo (asnjë ndryshim)*

Vazhdimi i status quo-së nënkupton që DhPGJS nuk do të pësonte ndryshime sipas kornizës aktuale ligjore, por të gjithë problematikat e identifikuara më sipër do të duhej të adresoheshin përmes veprimeve të brendshme, sipas strukturës ekzistuese. Përmes këtij opsioni, çështjet si delegimi i vendim-marrjes te një gjyqtar i vetëm apo koleg prej 2 anëtarësh do të duhej të zbatoheshin sipas autorizimeve aktuale në ligj. Megjithatë, mosndryshimi i politikës/ligjit për Dhomen e Posaçme potencialisht do të mundësonte vazhdimin e problemeve tashmë të identifikuara në këtë koncept dokument. Përmes ligjit aktual për DHPGJS së pari rrezikon të vazhdohet efikasiteti i ulët i punës në këtë Gjykatë, kryesisht për shkak të mënyrës ekzistuese të ndarjes së punës në kolege. Ngjashëm, ekzistojnë pengesa dhe konfuzitet lidhur me zbatimin dispozitave sa i përket ndarjes së kompetencave brenda, dispozitat lidhur me afatet ligjore në procedurat gjyqësore, dispozita lidhur me pranueshmërinë e padisë përkatësisht/ankesës, definimi i kompetencave të presidiumit të DHP dhe kryetarit të Gjykatës, përshtatja dhe rregullimi i terminologjisë në ligjin ekzistues me dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore (ku është e mundur).

##### *Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese – plotësim ndryshimi i ligjit ekzistues (opsioni i preferuar)*

Politika ekzistuese duhet të ndryshohet, duke miratuar ndryshim/plotësimet e propozuara në Ligjin të Dhomës së Posaçme, duke pasur parasysh por pa u kufizuar në

propozimet për adresimin e çështjes së përbërjes së kolegjeve të Gjykatës, numrit të gjyqtarëve të emëruar në këtë gjykatë, formën e funksionimit të brendshëm të gjykatës, mënyrën e regjistrimit dhe shqyrtimit paraprak para regjistrimit të lëndëve që dorëzohen në gjykatë.

Më konkretisht, neni i 3 Ligjit për DhPGjS do të pësonte një riformulim dhe ndryshim pothuajse në shumicën e paragrafëve të tij. Kjo së pari sa i përket përbërjes dhe përcaktimit të gjyqtarëve dhe largimit të kufizimit shprehimisht të maksimum 20 gjyqtarëve të emëruar në këtë gjykatë. Më tej, në po të njëjtin nen do të detajohej procedura e përzgjedhjes së kryetarit të DhPGjS dhe përvojës së kërkuar për gjyqtarët që do të emërohen në këtë gjykatë si dhe përcaktimi i kriteret e përvojës profesionale, të cilat janë aktualisht të përcaktuara vetëm për gjyqtarët ndërkombëtarë/EULEX-it. Njëkohësisht, tek kriteret e përvojës, është thelbësore që të sigurohen kriteret e njëjta si ato për gjyqtarët që shërbejnë në Gjykatën Supreme në mënyrë që të shmangen diskrepanca me Ligjin për Gjykatat dhe njëkohësisht të garantohet rekrutimi i gjyqtarëve me përvojën e duhur për nivelin e kësaj gjykate.

Ngjashëm, do të rishikohej ndarja me 5 kolegje sipas kompetencës primare për secilin kolegji dhe harmonizim i të gjithë dispozitave në ligj ku referohet kjo ndarje, si dhe forma e funksionimit dhe përbërjes së Presidiumit. Më konkretisht, plotësim ndryshimi i ligjit pritet që të shuaj kërkesën për ekzistimin e 5 kolegjeve me kompetenca primare dhe funksionimin e Gjykatës në panele të përbëra prej 3 gjyqtarësh në çështje të ndjeshme në shkallë të parë dhe prej 1 gjyqtari të vetëm në çështje më të thjeshta. Pra, në rastet e kërkesave për përfshirjen në listat e 20%-shit të punëtorëve në shkallë të parë, ankesave ndaj Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit, rastet që kanë të bëjnë me riorganizimin apo ristrukturimin e një N.Sh.-je, apo ato për kontestimin e statutit të një N.Sh.-je, të gjitha në shkallë të parë mund të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm në vend të një paneli prej 3 gjyqtarësh. Nga ana tjetër, rastet që kontestojnë një vendim të privatizimit apo edhe ato pronësore, për shkak të natyrës së ndjeshme dhe impaktit financiar të tyre mund të vendosen nga një panel prej 3 gjyqtarësh, duke rezervuar të drejtën si në nenin 9 të Ligjit aktual për delegim të përgjegjësisë dhe autoritetin për të mbajtur një pjesë apo procedurën e plotë për një rast nëse kjo vlerësohet si e arsyeshme nga paneli i tre gjyqtarëve.

Më tej, një pikë tjetër për t'u ndryshuar bën pjesë tek juridiksioni i përcaktuar në nenin 4 dhe parashtruesit tek neni 5, për të adresuar problematikën e ngritur nga praktika aktuale e kësaj Gjykate në lidhje me legjitimitet aktiv dhe pasiv të AKP-së në konteste dhe çështjes

së kompetencës ekskluzive të DhPGjS-së në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me AKP-në pavarësisht cilësisë së palës.

Po ashtu, një pjesë që pritet të adresohet në rast të plotësim-ndryshimit është sqarimi apo përcaktimi i detajuar i formës së zbatimit të parimit të kompensimit në vend të kthimit fizik sipas propozimit gjithëpërfshirës në harmoni me Ligjin për AKP-në, deri në sjelljen e një ligji të posaçëm që rregullon këtë çështje.

Dispozitat përkatëse që rregullojnë organizimin dhe funksionin e Zyrës së Regjistrimit (nenet 5 dhe 6 të Shtojcës së Ligjit për DhPGjS-në) do të riformuloheshin gjithashtu, duke shtuar kritere konkrete, siç është p.sh. shkollimi i lartë në administrim publik apo ngjashëm për krye-regjistruerin, si në mënyrë për të garantuar rritjen të efikasitetit të kësaj zyre dhe transparencës dhe llogaridhënies së punës së tyre. Në këtë linjë, detyrat dhe kompetencat e Presidiumit sa i përket caktimit të lëndëve në Kolegjet e Specializuara duhet të harmonizohen me ndryshimet si pasojë e shuarjes së kolegjeve me kompetenca të ndara apo edhe të shuhet në tërësi si organ brenda Gjykatës duke i kaluar kompetencat e mbetura pas ristrukturimit të kolegjeve tek kryetari i gjykatës, administratori dhe regjistrueri i gjykatës respektivisht.

Në vijim, neni 24 i Shtojcës së Ligjit për DhPGjS i cili përcakton kriteret e përfaqësimit pranë DhPGjS, duhet të riformulohet sa i përket përfaqësimit të personave fizikë në mënyrë që të garantohet përfaqësim i denjë dhe profesional dhe njëkohësisht shmangien apo reduktimin e parashtrësive të pasakta dhe jo të plota të dorëzuara në gjykatë. Kriteret për nisjen e procedurave dhe pranueshmërinë e kërkesave/ankesave në gjykatë sipas neneve 27-28 të Shtojcës së Ligjit për DhPGjS duhen riformuluar, duke prezantuar kritere më të detajuara dhe strikte, sidomos për pranueshmërinë e kërkesave/ankesave. Po ashtu, të parashihet detyrimi për një filtrim apo vlerësim paraprak i kërkesës/ankesë nga Zyra e Regjistrimit sa i përket kushteve bazë sipas nenit 27 të Shtojcës së Ligjit për DhPGjS për regjistrim, para regjistrimit të lëndës në gjykatë. Së fundmi, një reformulim i nenit 70 të Shtojcës së Ligjit për DhPGjS për të precizuar më tej procedurën dhe kriteret për dorëzimin e një ankese kundër Autoritetit të Likuidimit si dhe harmonizimin eventual të procedurës si pasojë e shuarjes së kolegjeve me kompetenca primare.

Për zbatimin e ndryshimeve dhe plotësimin e Ligjit të Dhomës së Posaçme palë të përfshira janë vet DhPGjS, KGjK-ja, Ministria e Drejtësisë, si dhe përfaqësues nga misioni i EULEX-it.

Megjithatë, paraqitet nevoja për trajnime si pasojë e ndryshimeve me objektiv kryesor rritjen e efikasitetit të punës, sidomos në lidhje me Zyrën e Regjistrimit si dhe kalimin e

lëndëve tek gjyqtarët vendorë dhe shuarjen e ndarjes në kolegje me kompetencat të veçanta. Vlerësohet nevoja për bashkëpunim me trupin e gjyqtarëve dhe stafit që pritet të largohet me përfundimin e mandatit të EULEX-it, për të mundësuar një tranzicion gradual por të suksesshëm dhe për të shmangur krijimin e një ngërçi në punën e gjykatës.

Po ashtu, si pasojë e natyrës specifike të juridiksionit dhe lëndëve të cilat trajton kjo gjykatë, nevojitet një kampanjë informimi për qytetarët, të cilët janë kryesisht vet palë në këtë gjykatë. Një kampanjë e tillë do të realizohej nga vet DhPGjS, në koordinim të plotë me KGJK-në dhe e mbështetur nga Ministria e Drejtësisë si dhe në bashkëpunim me përfaqësues nga mandati i EULEX-it të cilët janë të përfshirë aktualisht në këtë gjykatë dhe si rrjedhojë më të familjarizuar më punën dhe funksionimin e kësaj gjykate. E gjithë kjo iniciativë duhet të realizohet gjatë dhe menjëherë pas ndryshimeve eventuale të ligjit, në mënyrë që të vetëdijesohen edhe për ndryshimet përkatëse të cilat si përfundimin prekin qytetarët si palë në procedura të kësaj gjykate.

### *Opsioni 3: Hartimi i një ligji të ri*

Ndryshimi i qasjes ekzistuese të ligjit në fjalë, përmes ndryshimit të mënyrës së zbatimit, nuk është i mundur për shkak të arsyeve të cekura më lart në këtë dokument. Më konkretisht, përbërja e Gjykatës si dhe forma e funksionimit janë të rregulluara shprehimisht në ligj dhe sidomos në momentin e përfundimit të mandatit të EULEX-it, funksionimi i gjykatës do të pezmatohet automatikisht si pasojë e largimit të shtatë gjyqtarëve ndërkombëtarë/EULEX-it të cilët njëkohësisht janë pjesë përbërëse e secilit prej 5 Kolegjeve ekzistuese. Po ashtu, gjendja e rënduar si pasojë e numrit tejet të madh të lëndëve të grumbulluara nuk mund të ndërrohet përmes ndryshimit të mënyrës së zbatimit të Ligjit ekzistues, pasi një gjë e tillë është provuar në disa forma tre vitet e fundit por nuk ka rezultuar si e realizueshme apo e suksesshme. Për më tepër, nëse ligji ekzistues i Dhomës së Posaçme mbetet i pa ndryshuar, gjendja e rëndë në DhPGjS do të përkeqësohej edhe me tutje pasi numri i lëndëve në pritje veçse do të rritej.

Nga ana tjetër, nxjerrja e një ligji të ri për DhPGjS-në nuk vlerësohet si e nevojshme pasi pjesa dërrmuese e ligjit aktual, sidomos Rregullat procedurale në këtë Gjykatë të përcaktuara në Shtojcën e Ligjit për DhPGjS janë më se funksionale dhe rregullojnë në mënyrë të qartë dhe të duhur procedurat para kësaj Gjykate. Ajo që propozohet në këtë aspekt është vetëm integrimi i Shtojcës si pjesë procedurale së bashku me pjesën materiale të ligjit dhe të hiqet kategorizimi apo ndarja në formën e Shtojcës. Ndryshimet e referuara më sipër adresojnë problematikat e identifikuara sa i përket Ligjit dhe përveç riformulimit të një numri të caktuar të dispozitave të referuara më sipër, Ligji për DhPGjS

së bashku me Shtojcën e tij, nuk nevojiten ndryshime të tjera substanciale që do të arsyetonin nxjerrjen e një ligji të ri.

#### **Opsioni 4: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit**

Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit të Ligjit për DhPGjS nuk është i mundshëm dhe një ndër arsyet kryesore se përse arrihet në një konstatim të tillë është fakti se përbërja e kolegjeve dhe forma e funksionit të kolegjeve si në shkallë të parë ashtu edhe në të dytë është shprehimisht e caktuar në ligjin ekzistues. Më konkretisht, në secilin kolegji është shprehimisht e sanksionuar prezenca e një gjyqtari ndërkombëtar/EULEX-it dhe me përfundimin e mandatit të EULEX-it në gjyqësor, kjo gjykatë paralizohet në mënyrë permanente. Rrjedhimisht, në situatën aktuale, plotësim-ndryshimi i ligjit ekzistues është i domosdoshëm.

#### **Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve**

Përgatisni një tabelë që i përmbledh opsionet duke përdorur formën më poshtë. Kjo përmbledhje do t'iu ndihmojë të identifikoni informatat që mund të mungojnë, ose informatat të cilat do ta bëjnë secilin opsion shumë të qartë për vendimmarrësit.

<b>Përmbledhje e Opsioneve</b>				
<b>Karakteristikat kryesore</b>	<b>Opsioni 1</b>	<b>Opsioni 2</b>	<b>Opsioni 3</b>	<b>Opsioni 4</b>
Karakteristikat kryesore të opsionit	<i>Status quo</i>	Plotësimi dhe ndryshimi i ligjit për DhPGjS	Hartimi i një ligji të ri për DhPGjS	Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar	Palët në gjykatë qytetarët, KGjK, AKP	Palët në gjykatë qytetarët, KGjK, AKP	Palët në gjykatë qytetarët, KGjK, AKP	Palët në gjykatë qytetarët, KGjK, AKP
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	KGjK - DhPGjS, EULEX	MD, KGjK	MD, KGjK	DhPGjS, KGjK, MD
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	DhPGjS	DhPGjS	DhPGjS	DhPGjS

Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Ligji nr. 04/L-033, Ligji nr. 04/L-034, Ligji 05/-094, Rregullorja e KGjK-së nr. 09/2016 (me plotësim ndryshimet), Rregullorja e KGjK-së nr. 03/2014 (me plotësim ndryshimet)	Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit nr. 04/L-033, (ndryshimi enventual i Ligjit nr. 05/L-103)	Ligji i ri për DhPGjS	Ligji ekzistues i DhPGjS - nuk ka hapësirë për ndryshimin e qasjes ekzistuese të zbatimit të
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike - subvencionet ose taksat	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Nuk aplikohet	Kampanjë vetëdijësuese për qytetarët mbi të drejtat që burojnë nga ligji dhe mbi hapat procedural, Trajnim për gjyqtarët vendorë të rinj dhe ekzistues për trajtimin e lëndëve, Trajnim i Zyrës së Regjistrimit për administrimin dhe regjistrim	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet



		më efikas dhe transparent të lëndëve.		
Udhëzimet dhe kodet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni	Në fuqi aktualisht	Qershor 2018	2018	Nuk aplikohet

## Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

### Përfitimet

1. **Status-quo:** Ligji aktual, përkundër faktit se në pjesë më të madhe rregullon mjaftueshëm dhe qartësisht rregullat procedurale në këtë gjykatë, ka mangësi (të cilat janë elaboruar më sipër) sa i përket përbërjes dhe strukturës së organizimit të brendshëm të gjykatës. Rrjedhimisht, duke u bazuar nga analizat e mësipërme, nuk ka ndonjë përfitim nga vazhdimi i *status quo*-së, përveç se nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore që do të nevojiteshin eventualisht si edhe kufizimet kohore për ndryshimin e ligjit po nxjerrjen e një ligji të ri.
2. **Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit ekzistues për DhPGjS:** Siç është theksuar më sipër, pjesa dërrmuese e ligjit sidomos dispozitat për rregullat procedurale në gjykatë (Shtojca e ligjit për DhPGjS) ofrojnë një bazë të mirë dhe të qëndrueshme ligjore. Rrjedhimisht, në këtë situatë ndryshimi dhe plotësimi i vetëm pjesëve të cilat shkaktojnë pengesa dhe ngërçe në zbatimin e Ligjit ekzistues rezulton të jetë edhe opsioni më i arsyeshëm. Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit ekzistues do të shtonte efikasitetin dhe përgjegjësinë në mënyrën e funksionimit të gjykatës, duke mundësuar përshpejtimin e trajtimit të lëndëve dhe uljen e numrit të lëndëve të grumbulluara. Kjo sipas ndryshimeve të përbërjes së gjykatës në kuadër të gjyqtarëve që mund të emërohen dhe shërbejnë në këtë gjykatë, ndryshimit të formës së funksionimit të kolegjeve, duke shuar kompetencat primare për pesë kolegje të veçanta. Më tej, koordimi i punës së kësaj gjykate dhe harmonizim më i mirë me aktet e KGjK-së që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e brendshëm të gjykatave do të shtonte llogaridhënien dhe qëndrueshmërinë e kësaj gjykate. Po ashtu, ndryshime paraqiten të nevojshme edhe në dispozitat që rregullojnë punën e Zyrës së Regjistrimit do duke përcaktuar kritere konkrete në detyrat dhe përgjegjësitë e shërbyeseve në këto pozita që adresojnë rritjet të efikasitetit të kësaj zyre dhe transparencës dhe llogaridhënies së punës së tyre. Në

këtë linjë, detyrat dhe kompetencat e Presidiumit sa i përket caktimit të lëndëve në Kolegjet e Specializuara duhet të harmonizohen me ndryshimet si pasojë e shuarjes së kolegjeve me kompetenca të ndara. Të gjitha këto ndryshime dhe plotësime, të cilat janë evidentuar më detajisht më sipër, kanë për qëllim primar rritjen e efikasitet të punës së kësaj gjykate dhe uljen e ndjeshme të lëndëve të grumbulluara edhe të pazgjidhura. Po ashtu, në rast se dispozitat e ligjit që përcaktojnë përbërjen e gjykatës (numri dhe forma e gjyqtarëve) nuk ndryshohen, me përmbylljen e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë/EULEX-it në qershor 2018, e gjithë puna në gjykatë do të paralizohej si pasojë e prezencës së detyruar me ligj në secilin koleg të një gjyqtari ndërkombëtar/EULEX.

3. **Nxjerrja e një ligji të ri:** Përfitimet në këtë opsion, në shumicën dërrmuese, do të ishin si ato të paraqitura më sipër në opsionin 2, përveç se do të merrte më shumë kohë dhe kosto shtesë. Për më tepër, pjesa dërrmuese e ligjit ekzistues vlerësohet nga të gjithë palët e interesit se përmbush dhe rregullon mjaftueshëm dhe në mënyrë adekuate funksionimin e brendshëm të gjykatës. Rrjedhimisht, ndonëse një ligj i ri do të ofronte zgjidhje për të gjitha çështjet problematike të identifikuara më sipër, nga ana tjetër paraqet punë shtesë dhe të panevojshme, pasi për pjesën më të madhe të ligjit ekzistues nuk është paraqitur nevoja për ndryshim.
4. **Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit:** Duke u bazuar nga analizat e mësipërme, nuk ka ndonjë përfitim nga ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit. Kjo pasi përbërja e kolegjeve dhe forma e funksionit të kolegjeve si në shkallë të parë ashtu edhe në të dytë është shprehimisht e caktuar në ligjin ekzistues. Më konkretisht, në secilin koleg është shprehimisht e sanksionuar prezenca e një gjyqtari ndërkombëtar/EULEX-it dhe me përfundimin e mandatit të EULEX-it në gjyqësor, kjo gjykatë paralizohet në mënyrë permanente.

#### *Pasojat negative*

1. **Status quo:** Pasoja kryesore negative do të ishte paralizimi i plotës i punës në gjykatë, sidomos pas qershor 2018 kur edhe pritet të përmbillet mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë/EULEX-it. Vazhdimi i *status quo-së* ka po ashtu ndikim të drejtpërdrejtë dhe përbën shkelje të të drejtave të palëve të cilët veçse janë në procedurë në një proces të rregullt. Kjo sidomos duke marrë parasysh faktin se pjesa dërrmuese e palëve në procedurë veçse kanë vite që presin për zgjidhjen e lëndëve të tyre. Ngjashëm, mos-ndryshimi i situatës ka po ashtu kosto oportune siç është kufizimi i mundësisë për lëshimin në qarkullim të fondeve për kreditorët,

që aktualisht mbahen në mirëbesim nga AKP-ja apo edhe humbjen e besimit të qytetarëve në institucionet e gjyqësorit.

2. **Plotësimi dhe ndryshimi i ligjit ekzistues:** Ky opsion, duke marrë parasysh afatet kohore që nevojiten për plotësim dhe ndryshimet e Ligjit, mund që të shkaktojë një stagnim të përkohshëm të punës së gjykatës, sidomos në kuadër të ndryshimeve që pritet të ndodhin në qershor si pasojë e përmbylljes së mandatit të EULEX-it në këtë gjykatë.
3. **Nxjerrja e një ligji të ri:** Ky opsion parasheh një krijimin e një ligji tërësish nga e para, e cila përveçse është veprim më komplekse dhe kërkon më shumë kohë, mund të rezultojë me ndryshim të më shumë se një akti ligjor. Ky opsion do të kishte potencialisht ndikim më të madh financiar dhe mund të duhet kohë më e gjatë për fillimin e zbatimit të tij. Njëkohësisht, do të stagnonte ndjeshëm punën e Gjykatës deri në nxjerrjen e ligjit të ri dhe mund të krijojë konfuzitet tek përaferësisht 21000 palë që tashmë veçse janë në procedurë në këtë gjykatë.
4. **Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit:** Duke iu referuar faktit se ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit është i pamundur për arsytet e referuara më sipër, pasojat negative në këtë situatë janë pothuajse identike me ato të identifikuar në opsionin nr. 1 – ruajtja e *status quo*-së.

### **Kosto**

Për zbatimin e politikës së propozuara, pra plotësimin dhe ndryshimin e ligjit ekzistues, vlerësohet se nuk ka implikime financiare shtesë, ngase nuk parashihet të krijohen institucione shtesë. Nga ana tjetër, shtimi i stafit profesional kërkon kosto shtesë, mirëpo sa i përket fazës së parë të rekrutimit të paraparë për vitin 2018, shtimi i personelit, stafit edhe gjyqtarëve veçse është paraparë aktualisht me rritjen e buxhetit të KGJK-së për vitin 2018.

Megjithatë, vlen të theksohet se DhPGJS funksionon si një entitet gjyqësor më vete brenda Gjykatës Supreme të Kosovës. Andaj paraqitet nevoja që KGJK-ja të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një linje të veçantë buxhetorë për DhPGJS brenda buxhetit të paraparë vjetor për këtë gjykatë, mirëpo i cili administrohet ndaras nga ai i Gjykatës Supreme. Kjo për të siguruar më shumë pavarësi dhe efikasitet në alokimin e resurseve për nevoja të kësaj gjykate. Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se resurset ekzistuese të kësaj

Gjykate duhet të ristrukturohen që të garantohet shfrytëzim sa më i balancuar, i arsyeshëm edhe efikas i tyre.

Sa i përket trajnimeve për organet zbatuese dhe kampanjave eventuale vetëdijësuese për qytetarët, të njëjtat mund të përfshihen edhe në kuadër Akademisë së Drejtësisë, e cila ka ndarje buxhetore për ofrimin e trajnimeve. Njëkohësisht, kampanjat vetëdijësuese mund të sponsorizohen apo mbulohen edhe nga projektet ekzistuese të donatorëve në fushën e gjyqësorit.

<b>Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar</b>				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
<b>Opsioni 1</b>				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				
<b>Opsioni 2</b>				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				
<b>Opsioni 3</b>				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				

<b>Opsioni 4</b>				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				

Në një Aneks të veçantë duhet të përfshihet një tabelë e hollësishme e ndikimit financiar të secilit opSION. Kjo tabelë duhet të përmbajë informatat relevante në formularin e Vlerësimit të Ndikimit Financiar.

### **Kapitulli 7: Konsultimi**

Për rregullimin e fushës së lartpërmendur konsultimet kanë filluar më herët dhe si rezultat i konsultimeve është arritur në konkluzionin se është e nevojshme që kjo fushë të rregullohet me plotësimin dhe ndryshimin e ligjit ekzistues, detajuar më sipër.

Konsultimet kanë përfshirë ekspertë dhe njohës të veprimtarisë së kësaj gjykate, përfaqësues nga KGJK-ja, përfaqësues nga gjyqtarët vendorë të DhPGjS, përfaqësues nga gjyqtarët ndërkombëtarë/EULEX të DhPGjS si dhe përfaqësues nga AKP-ja, të cilët kanë shprehur pikëpamje të ndryshme për mënyrën e ristrukturimit dhe përbërjes së kësaj gjykate dhe formës së organizimit të brendshëm. Megjithatë, opinioni i përgjithshëm i grupit konsultues si më sipër qëndron në plotësimin dhe ndryshimin e ligjit ekzistues si opsioni më i përshtatshëm për të adresuar gjendjen aktuale. Përfaqësues të organeve dhe akterëve të lartpërmendur kanë marrë pjesë në komentimin e draftit të parë të këtij koncept dokumenti i cili është qarkulluar fillimisht dhe pjesa dërrmuese e komenteve të tyre janë përfshirë në propozimet e dhëna më sipër. Një pjesë e konsultimeve në lidhje me disa nga problematikat e ngritura kanë qenë pjesë edhe gjatë procesit të hartimit të Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore, ku si rezultat i konsultimeve ka dalë konkluzioni se është e nevojshme që disa nga pikat e identifikuara më sipër të rregullohen edhe përmes intervenimit në zbatimin e Ligjit për DhPGjS

### **Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve (vlerëso pasojat e secilit opSION)**

1. Opsioni nr. 1 - *status quo* (asnjë ndryshim), sipas vlerësimit do të lejonte edhe më tej vazhdimin e pasojave negative, deri në paralizimin e plotë të punës së gjykatës si dhe zbatimin jo efikas të legjislacionit në fuqi. Duke mos ndërmarrë asnjë veprim, po ashtu do të bllokohej edhe puna e institucioneve të tjera që lidhen ngushtë apo veprimtaria e tyre është drejtpërdrejtë e lidhur me funksionimin e

kësaj gjykate, siç është p.sh. shpërndarja tek kreditorët e fondeve në likuidim, të mbajtura aktualisht nga AKP-ja në mirëbesim.

2. Opsioni nr. 2 – plotësimi dhe ndryshimi i ligjit ekzistues ofron mundësinë më adekuate dhe efikase për zhblokimin e ngërçit i cili pritet të krijohet me përfundimit e mandatit të EULEX-it në këtë gjykatë si dhe rritjen e efikasitet të punës përmes ndryshimit të funksionimit të brendshëm të gjykatës. Ky opsion, jo vetëm që nuk parasheh implikime shtesë financiare por mbi të gjitha përkon edhe me afatet kohore që rrjedhin si pasojë e zhvillimeve të tjera, qoftë edhe politike, siç është p.sh. krijimi i 7 vëndeve të lira me ikjen e gjyqtarëve ndërkombëtarë/EULEX-it. Njëkohësisht, përmes shuarjes së formës ekzistuese të funksionimit në 5 kolegje me kompetenca primar, në një ristrukturim më efikas dhe mundësinë e vendosjes përmes një gjyqtari në lëndë të caktuara, rritet efikasiteti i Gjykatës, çka ndikon drejtpërdrejtë në uljen e numrit të lëndëve të vjetra të pazgjidhura.
3. Opsioni nr. 3 – nxjerrja e një ligji të ri, ndonëse ofron mundësinë për të rirregulluar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të kësaj gjykate si dhe përbërjen e saj, megjithatë konsiderohet se do të konsistonte në punë dhe kosto shtesë dhe të panevojshme. Kjo si pasojë e faktit se ligji ekzistues në pjesën më të madhe të tij mbulon dhe rregullon mjaftueshëm edhe adreson si duhet procedurën, strukturën dhe kriteret dhe juridiksionin e kësaj gjykate. Ky opsion kërkon angazhim dhe ndryshim më të madh institucional dhe legjislativ dhe zbatimin e tij kërkon më tepër kohë dhe mund të ketë implikime buxhetore.
4. Opsioni nr. 4 – ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit, është vlerësuar si i pamundur dhe konsiderohet se vetëm shkakton pasoja negative duke mos identifikuar asnjë përfitim që mund të nxirret nga ky opsion. Në fakt rezultat i këtij opsioni është në vijë të fundme paralizimi i plotë i punës së gjykatës si dhe zbatimin jo efikas të legjislacionit në fuqi.

### **Kapitulli 9: Rekomandimi**

Plotësimi dhe ndryshimi i ligjit ekzistues, në pajtim me opsionin nr. 2, do të mundësonte arritjen e qëllimeve dhe objektivave të përmendura në fillim të këtij dokumenti. Rritja e efikasitetit dhe llogaridhënies së kësaj gjykate, ristrukturimi i përbërjes, përsheptimi i kohës së trajtimit të lëndëve dhe reduktimi i numrit të lëndëve të vjetra të grumbulluara (siç janë elaboruar më sipër) janë të gjitha objektiva të matshme dhe të arritshme përmes ndryshimit dhe plotësimit të dispozitave përkatëse në ligjin ekzistues.

Rekomandimi është që Qeveria e Republikës së Kosovë të miratojë Koncept Dokumentin me qëllim që sa më parë të evitohen të metat ekzistuese nga numri i madh i lëndëve të grumbulluara dhe ndryshimet që pritet të ndodhin në përbërjen e gjykatës, të cilat janë evidentuar si pasojë e mangësive dhe kufizimeve në ligjin aktual. Në rast të miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Drejtësisë, në koordinim me institucionet dhe aktorët përkatës, do të fillojë procesin e plotësimit/ndryshimit të ligjit për DhPGjS, duke shtuar edhe ndryshuar dispozitat përkatës për rregullimin e pikave problematike të evidentuara më sipër. Të njëjtat më pas do t'i dërgojë në Qeveri për procedim të mëtejshëm.

### **Kapitulli 10: Komunikimi**

Ministria e Drejtësisë, në bashkëveprim me Ministrinë e tjera të linjës, KGjK, DhPGjS, EULEX, AKP dhe institucionet e tjera përkatës do të jenë të përqendruar në ofrimin e informacioneve lidhur me detajet e procesit të plotësimit/ndryshimit të ligjit, ku do të merren parasysh propozimet dhe komentet e aktorëve të ndryshëm relevantë si dhe konsultimet me ekspertët e kësaj fushe dhe shoqërinë civile.

Format e komunikimit pritet të jenë të ndryshme, të cilat variojnë nga takimet dhe grupet punuese, publikimet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera përkatëse. Plani i komunikimit në mes të këtyre aktorëve parashihet të jetë aktiv, i drejtpërdrejtë dhe me synim që të arrihet një debat konstruktiv rreth propozimeve në fjalë.